

# KONTRATË

## DHURIM KUOTASH

Sot më datë 21.10.2021 në Tiranë nënshkruhet kjo kontratë për dhurim kuotash me palë si vijon:

### Pala DHURUESE

Z. Amar Mileti, lindur në Tiranë, më 26.08.1993, identifikuar me numër personal J30826057E, madhor e me zotësi të plotë juridike, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë PARK STUDIO SHPK, regjistruar me NUIS M01330023E që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë dhuruese.

### Pala PRANUESE

Z. Endi Balza, lindur në Elbasan, më 02.11.1994, identifikuar me nr personal J41102111D, me zotësi të plotë për të vepruar, madhor e me zotësi të plotë juridike, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë pranuese,

të cilët shprehën vullnetin e tyre të lire dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar kontratën e transferimit të kuotave të kapitalit themeltar si më poshtë :

### NENI 1

#### OBJEKTI I KONTRATËS

Në përputhje me nenin 73, 74 të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" z. Amar Mileti, i dhuron me vullnet të lirë z. Endi Balza 9 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me vlerën 900,00 lekë, që zotëron në shoqërinë "PARK STUDIOS" shpk.

Pala dhuruese është ortak i vetëm i shoqërisë "PARK STUDIOS" SHPK e regjistruar në QKB dhe organet tatimore me NUIS M01330023E. Pala dhuruese është zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit, me një vlerë kapitali prej 10.000,00 lekë.

Pala pranuese, Endi Balza me vullnet të lirë dhe të plotë i pranon 9 % të kapitalit themeltar të shoqërisë PARK STUDIO SHPK, e barabartë me 1 kuotë.


### NENI 2

#### TRANSFERIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kontratës së transferimit (dhurimit) të kuotave të cituara më lart pala dhuruese zhvishet nga 9 % e kapitalit e barabartë me 1 kuotë, me një vlerë të kapitalit prej 900,00 lekë që gëzon në shoqëri, dhe pala pranuese bëhet zotëruese e pjesës së dhuruar prej 9 % të kapitalit baraz me 1 kuotë me një vlerë të kapitalit prej 900,00 lekë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate ortakë të shoqërisë "PARK STUDIOS" shpk janë :

- 1) **Z Amar Mileti** - zotërues i 91 % të kapitalit të shoqërisë, ose 1 kuote me një vlerë të kapitalit prej 9.100,00 lekë.



- 2) **Z. Endi Balza** - zotërues i 9 % të kapitalit të shoqërisë, ose 1 kuote me një vlerë të kapitalit prej 900,00 lekë.

Pala pranuese merr përsipër të gjitha të drejtat e detyrimet e shoqërisë sipas përqindjes së kuotave të kapitalit që gëzon në shoqëri që nga momenti i nënshkrimit të kontratës së dhurimit e në vijim.

Pala pranuese nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet që pala dhuruese mund të ketë jashtë shoqërisë.

### NENI 3

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata u përpilua në tre kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në regjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse.

#### PALËT KONTRAKTUESE

**PALA DHURUESE**

**Amar MILETI**



**PALA PRANUESE**

**Endi BALZA**

